



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

---

**Legjislatura VIII**

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Legjislacion, Mandate,  
Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen  
e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 119

Prishtinë, më 17.10.2024, në ora 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Adnan Rustemi, Arijeta Rexhepi, Artan Abrashi, Dimal Basha, Driton Selmanaj, Erxhan Galushi dhe Hajdar Beqa.

**Munguan:** Besnik Tahiri, Blerta Deliu- Kodra dhe Hydajet Hyseni- Kaloshi.

**Mbledhjen e kryesoi:** Adnan Rustemi, kryetar i Komisionit.

**Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë:** Yllka Kllokoqi, KDI; Bashkim Xhukolli, Arbresh Info; Edonë Podvorica, RTK; Detrina Alishani, Kuvendi i Kosovës.

**Stafi mbështetës i Komisionit:** Mirlinda Kolgeci dhe Fatbardha Boletini.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më datë 17.9.2024;
3. Shqyrtimi i draft-planit të punës së Komisionit për sesionin vjeshtor 2024;
4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit funksional për Projektligjin nr.08/L-265 për regjistrin e pronarëve përfitues;
5. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit funksional për Projektligjin nr.08/L-284 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunës;
6. Shqyrtimi i raporteve të komisioneve kryesore për Projektligjin nr.08/L-276 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve të veçanta, për krijimin e bazës ligjore për nxjerrjen e akteve nënligjore nga Qeveria dhe ministrat;
7. Shqyrtimi i raporteve të komisioneve kryesore për Projektligjin nr.08/L-283 për harmonizimin e ligjeve të veçanta me Ligjin 05/L-087 për kundërvajtje;
8. Të ndryshme.

### 1. Miratimi i rendit të ditës

**Kryetari** konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

### 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më datë 17.9.2024

**Kryetari** konstatoi se procesverbali i datës 17.9.2024, u miratua pa vërejtje.

### 3. Shqyrtimi i Draft-planit të punës së Komisionit për sesionin vjeshtor 2024

**Kryetari**, tha se Komisioni për Legjislacion, gjatë kësaj legjislature, është angazhuar në frymë të bashkëpunimit përtej dallimeve politike partiake, natyrisht përveç projektligjeve të caktuara që ka pasur mospajtime. Pjesa tjetër e punës është karakterizuar nga një frymë bashkëpunimi. Komisioni ka trajtuar një numër të madh të projektligjeve, por edhe mbikëqyrje të zbatimit të ligjeve. Më pas, ai tha se tani po shqyrtojnë planin e punës për sesionin e fundit të kësaj legjislature, i cili reflekton synimet e këtij sesioni dhe sa do të jetë e mundur që të përmbushet, është çështje tjetër, duke marrë parasysh faktin që jemi në sesionin e fundit të legjislaturës së VIII.

**Hajdar Beqa**, tha se sa i përket aktiviteteve të komisionit, për sesionin vjeshtor apo planit të punës, duke pasur parasysh edhe rrethanat të cilat jemi, gati në prag të zgjedhjeve, duke pasur parasysh sidomos së ditëve të fundit, opozita po mban seanca vetëm, pozita po ikë nga përgjegjësia që kanë ndaj qytetarëve, askush nuk po e ka më shumicën në Parlamentin e Republikës së Kosovës dhe nuk besoj që mund të realizohet ky plan. Po ashtu, tha se nuk e sheh se ka vullnet politik për funksionim të Kuvendit, si institucioni më i lartë i këtij vendi, andaj potencoi se është i rezervuar në lidhje me planin e punës.

Duke pasur parasysh edhe rrethanat e reja dhe ikjen nga përgjegjësia apo të paktën ikjes nga sqarimi, ndërhyrjen siç ishte rasti i Dejonës, pa e ditur se çfarë përfaqëson, përgjimet që po ndodhin nga shefja e grupit të partisë që e udhëheq shtetin dhe mungesa e bukës në ushtri, e ikjet nga seanca, më duket e pakuptimtë të ketë një plan pune, shtoi deputeti Beqa.

**Driton Selmanaj**, tha se ka gjashtë muaj, ndoshta edhe më shumë, që Kuvendi nuk po arrin t'i kthehet normalitetit asnjëherë, nuk është çështje vetëm e këtyre ditëve të fundit, por nuk po arrin t'i përfundojë seancat, dhe duke marrë parasysh këto rrethana, edhe ky plan po më duket shumë ambicioz dhe i parealizueshëm, tha ai.

**Kryetari**, tha se sido që të jetë, plani i punës reflekton në masë të madhe planin legjislativ, është çështje tjetër se a do të jetë e mundur që të përmbushet. Asnjëherë, në asnjë sesion, plani i punës nuk është përmbushur në përpikëri, megjithatë është një lloj orientimi për punën e Komisionit. Kryetari propozoi që të miratohet, në kuptimin e përgjegjësive, si komision.

**Hajdar Beqa**, tha se vullneti i anëtarëve ekziston, që ta shohin si plan pune, sepse është obligim të kenë një plan pune, por nëse nuk funksionon seanca, ikin mazhoranca nga seanca, ka ndodhur të lëshojë sallën opozita, por të lëshojë sallën shumica, kjo ndodh vetëm në Kosovë.

Të shohim se sa do të vazhdojë Kuvendi më tutje, apo është i interesuar të bëjë zhurmë deri në zgjedhje dhe të përdorë secilin institucion për fushatë zgjedhore, theksoi ai.

**Dimal Basha**, tha se plani është i realizueshëm, vetëm varet nga vullneti i anëtarëve, shumica e punëve mund të realizohen. Për më tepër, mbikëqyrja e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale ka mbetur në gjysmë dhe nëse ka vullnet nga kolegët, mund ta përfundojmë, për shkak se nuk ka mbetur shumë aty, përveç disa vizitave që duhet bërë. Për hir të korrektësisë, z. Selmanaj ka qenë i pranishëm, por disa anëtarë të tjerë për arsye të ndryshme nuk kanë qenë pjesë e mbikëqyrjes. Pra, nëse është vullneti, së paku të bëhen mbikëqyrje dhe vizita nëpër institucione, sepse këto janë vetëm raporte që pastaj mund të procedohen dhe mbesin në sirtarët e Kuvendit.

Pozita po merr pjesë në seanca, por në votime opozita nuk po merr pjesë, dhe derisa të refuzoni të merrni pjesë në votimet e ligjeve, është pak e arsyeshme të vijmë të merremi me shpifjet që bëhen nëpër media, e që ushqehen nga Lista Serbe. Është e rëndësishme sa merrni pjesë në votimet e ligjeve, dhe jo të refuzoni votimin e ligjeve. Pajtohemi që kemi 51%, por kjo nuk e përjashton asnjë deputet nga përgjegjësia për të votuar ligje, sepse jemi aty për të votuar ligje, për debate që janë të mirëfillta, substanciale dhe që ka interes qytetari, jo për shpifjet që i bëjnë disa media dhe ne të merremi me ta, theksoi ai.

**Hajdar Beqa**, falënderoi mediat dhe në të njëjtën kohë shpreh keqardhje për nivelin e televizionit publik, RTK, duke mos transmetuar seancat. Kjo është e palogjikshme, e papranueshme, por është edhe e pafalshme. Mediat po prezantojnë një situatë reale, mediat nuk kanë shkuar t'i thonë Mimoza, shëfës së grupit të Vetëvendosjes, koordinohu me Radojçiqin. Mimoza, si shëfë e grupit, që përfaqëson partinë që udhëheq me institucionet në kohën kur Radojçiqi kërkohet nga organet e shtetit, ajo koordinohet për agjendë të shtetit, këto nuk konsiderohen shpifje, por punë që i ka bërë dikush, për të cilat duhet të përgjigjet. Dhe nëse janë shpifje, Mimoza dhe Vetëvendosja duhet të vijnë të përgjigjen, theksoi ai.

*Meqë nuk pati diskutime tjera, kryetari konstatoi se me 5 vota për dhe 2 kundër, miratohet plani i punës së Komisionit për sesionin vjeshtor 2024.*

#### **4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit funksional për Projektligjin nr.08/L-265 për regjistrin e pronarëve përfitues**

**Kryetari**, tha se Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti, ka paraqitur 23 amendamente. Komisioni për Legjislacion, në pajtim me nenin 76, paragrafi 8 i Rregullores, vlerëson se projektligji dhe amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.

*Meqë nuk pati diskutime të tjera, kryetari konstatoi se me pesë vota për dhe një abstenim, u miratua raporti me amendamente dhe vendosi që Kuvendit dhe Komisionit funksional t'ia paraqesë këtë:*

#### **Rekomandim**

1. Projektligji nr.08/L-265 për regjistrin e pronarëve përfitues dhe amendamentet e propozuara, janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund t'i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

#### **5. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit funksional për Projektligjin nr.08/L-284 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunës**

Kryetari shtoi se Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal ka paraqitur 7 amendamente. Komisioni për Legjislacion vlerëson përputhshmërinë me Kushtetutën dhe ligjet e zbatueshme.

*Meqë nuk pati diskutime të tjera, kryetari konstatoi se me pesë vota për dhe një abstenim, u miratua raporti me amendamente dhe vendosi që Kuvendit dhe Komisionit funksional t'ia paraqesë këtë:*

## Rekomandim

3. Projektligjin nr. 08/L-284 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunës dhe amendamentet e propozuara, janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
4. Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund t'i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.
6. **Shqyrtimi i raporteve të komisioneve kryesore për Projektligjin nr.08/L-276 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve të veçanta për krijimin e bazës ligjore për nxjerrjen e akteve nënligjore nga Qeveria dhe ministrat**

*Kryetari konstatoi se nuk pati kuorum votimi për këtë pikë, andaj pika mbetet për mbledhjen e ardhshme.*

7. **Shqyrtimi i raporteve të komisioneve kryesore për Projektligjin nr.08/L-283 për harmonizimin e ligjeve të veçanta me Ligjin 05/L-087 për kundërvajtje**

Kryetari, tha se po ashtu është shqyrtimi i raporteve nga komisionet kryesore të një projektligji, për të cilin Komisioni për Legjislacion ka qenë Komision funksional.

*Meqë nuk pati diskutime tjera, kryetari konstatoi se Komisioni, me pesë vota për dhe një kundër, vendosi që Kuvendit t'i rekomandohet për lexim të dytë, Projektligji nr. 08/L- 283 për harmonizimin e ligjeve të veçanta me Ligjin 05/L-087 për kundërvajtje.*

## 8. Të ndryshme

Kryetari njoftoi anëtarët e komisionit me përfundimin e Kryesisë, për përfshirjen në delegacionet e komisioneve parlamentare në udhëtime dhe vizita zyrtare edhe për përfaqësuesit e komuniteteve. Ai tha se kjo nuk vlen për Komisionin për Legjislacion, pasi në çdo vizitë ishin të përgjegjshëm për këtë pikë.

Mbledhja përfundoi në orën 10:25.

E përgatiti:  
Stafi mbështetës i Komisionit.

**Adnan Rrustemi,**  
Kryetar i Komisionit

-----